



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1175/Prot.
2

Tiranë, më 25/07/2019

VENDIM

Nr. 22 datë 25.07.2019

“PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË TË DHËNAVE
HISTORIKE HIDROLOGJIKE DHE METEOROLOGJIKE TË STACIONEVE NË
FUNKSION TË KADASTRËS KOMBËTARE TË BURIMEVE UJORE”.**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, pika 4, neni 89 i ligjit 111/2012 ‘Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore’, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresës së IGJEUM nr. Prot157/1, datë 23.07.2019, Bordi i Administrimit vendosi,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së IGJEUM, për vënien në dispozicion të të dhënave historike hidrologjike dhe meteorologjike të stacioneve në funksion të kadastrës kombëtare të burimeve ujore;
2. Vënia në dispozicion e të dhënave të kërkuara të realizohet brenda kostove të punës që burojnë prej fondit të pagave të planifikuar në buxhet për Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
3. Të dhënat që do të vihen në dispozicion mbeten pronësi intelektuale e UPT, dhe palët e interesit nuk mund ti përdorin për të tretë për qëllime aktiviteti ekonomik pa miratimin paraprak të UPT;
4. Ngarkohet për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ARBEN DHIMA

